



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Nr. 1449 prot.

Tiranë, më 27.4 2016

Shërbimit të Seancës
[Signature]

Drejtuar: **Zotit Ilir META**
KRYETAR I KUVENDIT

A M E N D A M E N T

(24 orë para votimit në seancë plenare)

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.10091, DTË 5.3.2009 “PËR AUDITIMIN LIGJOR, ORGANIZIMIN E PROFESIONIT TË EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR DHE TË KONTABILISTIT TË MIRATUAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 75 pika 4 të Rregullores së Kuvendit, paraqes amendamentin si më poshtë:

Në projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10091, dtë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, propozoj të bëhet një ndryshim, si më poshtë:

Në nenin 7, pika 1 shkronja “c” riformulohet si më poshtë:

“c) kryer gjysmën e praktikës profesionale, e cila zgjat në total 3 vjet, në kushtet e punësimit me kohë të plotë në auditimin e pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe/ose të konsoliduara ose pasqyrave financiare të tjera, të ngjashme, pranë një audituesi ligjor ose shoqërie auditimi të njohur në Republikën e Shqipërisë, që dallohet për reputacion të mirë dhe nën udhëheqjen e audituesve ligjorë që kanë garancitë e mjaftueshme për këtë qëllim.

Të paktën, dy të treta t e kësaj praktike profesionale duhet të kryhen pranë një audituesi ligjor ose një shoqërie audituese, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë.”.

DEPUTETI PROPOZUES

Anastas ANGIJELI

[Signature]